

## Procesverbal

Nga seanca e I-rë(parë)/2019 e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 31.01.2019, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

### Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i 2 procesverbaleve, nga seancat e mëparshme të KK-së Dragash:
  - a) Seancës së XI-të (të jashtëzakonëshme) të Kuvendit Komunal-Dragash,
  - b) Seancës së XII-të të Kuvendit Komunal-Dragash,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor të Arsimit për Komunën e Dragashit, për periudhën 2019-2023,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Rregullores për Ndryshimet dhe Plotësimet e Rregullores mbi Lartësin e Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale,
4. Plotësimi i Komisionit për Dhënin në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komuale, dhe
5. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësimë të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, miratojmë, njëzëri, rendit e ditës-sipas Ftesës...

### Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e procesverbaleve riga është seancat e mëparshme te Kuvendit Komunal të Dragashit:

- a) Prosesverbalit të seancë së XI-të (të jashtëzakonëshme), nëse ka vërejtje apo plotësimë...? Nëse nuk ka, e miratojmë Prosesverbalin e seancës së XI-të (të jashtëzakonëshme),
- b) Kalojmë edhe në Prosesverbalin e seancës së XII-të Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësimë...? Nëse nuk ka, e miratojmë edhe Prosesvebrbalin e seancës së XII-të.

### Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Pra, vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Dragashit, për periudhën 2019-2023 dhe lidhur me këtë, fillmisht, fjalën e ka kryetari Komunës z.Shaban Shabani...

"Plan Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Dragashit është hartuar me pjesëmarrje të gjithë tjerë të gjitha palëve me interes dhe paraqet dokumentin bazë për zhvillimin e arsimit në nivel komunal për një periudhë pesëvjeçare 2019-2023. Hartimi i Planit Zhvillimor për Arsim në Komunën e Dragashit është mbështetur nga Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), koalicion strategjik i udhëhequr nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe katër organizata tjera të shoqërisë civile. Procesi i planifikimit është drejtuar nga Grupi për Planifikim i themeluar nga Drejtori Komunal për Arsim në Komunën e Dragashit dhe është mbështetur nga ekspertë të arsimit të angazhuar nga projekti KEEN.KEEN ka ofruar mbështetje për nëntë komuna të Kosovës, në mesin e tyre edhe komuna e Dragashit, për hartimin e planeve zhvillimore për arsim. Ky proces është zhvilluar në katër fazë kryesore:

### Faza 1: Analiza e gjendjes ekzistuese

Grupi për planifikim në punëtorinë e parë për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor për Arsim (PZHA), përcaktoi pesë fusha të veprimit me interes për arsimin në Komunën e Dragashit:

- Menaxhimi dhe qeverisja;
- Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- Kultura dhe mjedisi shkollor;
- Zbatimi i kurrikulës së re; dhe
- Arsimi dhe aftësimi profesional.

Në bazë të analizës së gjendjes në pesë fushat tematike të përcaktuara për procesin e planifikimit, grupi punues për hartimin e këtij plani zhvillimor ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet përkatëse.

Vizioni: Rritja e mirëqenies qytetare, demokratizimi i shoqërisë, zhvillimi i kulturës së punës dhe dijes, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore, përdorimit të teknologjisë në arsim, zhvillimit të infrastrukturës, si dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve arsimore.

Misioni: Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e komunës që mundëson zhvillimin e kompetencave të tyre në përputhje me mundësitë dhe arritjet më të reja të dijes dhe vlerave, mundësi të barabarta për vazhdim të suksesshëm të shkollimit dhe punësimit.

### Faza 2: Përcaktimi i objektivave strategjikë dhe masave për arritjen e tyre

Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunes se Dragashit ka pesë objektiva strategjike, një për secilën fushë të intervenimit.

OS 1 - Menaxhim cilësor dhe efikas i arsimit në nivel komune dhe shkolle i bazuar në integrim, transparencë dhe llogaridhënie.

OS 2 - Ndërtimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësimdhënie cilësore.

OS 3 - Krijimi i mjedisit të përshtatshëm shkollor dhe kulturës së punës për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të lira dhe ekstra-kurrikulare për të gjithë nxënësit.

OS 4 - Përmirësim i cilësisë së zbatimit të kurrikulës duke u bazuar në parimet e saj.

OS 5 - Ndërlidhje më e mirë e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

### Faza 3: Hartimi i planit të veprimit dhe buxhetit

Plani i zbatimit dhe buxheti, përfshijnë gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit 2019-2023. Kostoja e përgjithshme e zbatimit të PZHA për periudhën 2019-2023 është vlerësuar të jetë 663,000 €. Si plani i zbatimit, ashtu edhe planifikimi i buxhetit brenda periudhës së PZHA janë orientues dhe në parim kërkojnë të rishikohen në baza vjetore.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit për realizimin e PZHA-së është planifikuar të jetë nga Buxheti i Kosovës, nga të hyrat dhe burimet vetanake të Komunës, ndërsa një pjesë bazohet në mbështetjen nga donatorët, me të cilët autoritetet komunale duhet komunikuar dhe duhet përgatitur projekte për aplikim me rastin e thirrjeve nga donatorë që mbështesin fushën e arsimit.

#### Faza 4: Hartimi i dokumentit të Planit Zhvillimor për Arsim

Drafti përfundimtar i dokumentit të PZHA është përgatitur në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit të planifikimit dhe në bazë të konsultimeve dhe udhëzimeve të grupit komunal për hartimin e PZHA. Gjatë kësaj faze, PZHA është riorganizuar dhe ka marr formën përfundimtare për aprovim nga organet vendimmarrëse në Komunën e Dragashit.

Përgjegjësia për zbatimin e Planit Zhvillimor të Arsimit i takon Drejtorisë Komunale të Arsimit, e cila duhet të bashkërendojë detyrat me institucionet arsimore të komunës dhe me njësitë tjera në nivel komune. Ndërkaq, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit është Kuvendi Komunal përmes Komitetit për Arsim, i cili të paktën një herë në vit shqyrton raportet e DKA-së për zbatimin e Planit Zhvillimor, progresin dhe nevojat për rishikim e vazhdim të zbatimit të planit.

Të nderuar delegatë, shpresojmë se diskutimet tuaja do t'i kontribuojnë plotësimit të këtij Plani dhe miratimin e tij. Ju faleminderit !"

Iaurat Krasnini- Kur flasim për çështjen e arsimit në komunën e Dragashit e cila në statistika e në bazë të shënimëve që i kemi në këtë material, shifat se, nga viti 2014, kemi rënje të vazhdueshme të nxënësëve. Ky fakt është normal, kur dihet faktori demografik dhe biologjik. Ndërkaq, ne si institucione dhe subjekte politikke, e kemi vërejtur se ky sektor është politizuar në tërësi, nga se, partia në pushtet dhe personat që e përfaqësojnë këtë subjekt poltiikë, arsimin po e shfrytëzon si mjet për të tubuar vota nga elektorati. T'a marrim si rast, rastin e fundit i cili ka ngjarë në Zaplluxhe e Blaç ku, paraprakisht, është dijtur kandidadfui i i cli do të pranohet, para publikimit të Konkursit?! Ne njihemi dhe nëse është ashtu, nuk ka nevojë të themelohen komisione dhe mos të mundohen kandidatët që të aplikojnë! Për ne, si parti politike VV, është shqetësues fakti se kuadri i cili pranohet në këto pozicione në arsim është kuadër pa bazë dhe se punësimi është plotësish politikë, kurse persona të caktuar të cilët kanë përfunduar shkollat, me mund dhe sakrifica dhe me vite të tëra, janë dëmtuar si në ish-sistemin komunist, para luftës. Në ish-sistemin e komunizmit, babai im, shpesh-herë, ka qenë anëtar i komisioneve dhe ka qenë urdhërat strikte se kandidati i caktuar nuk ka mundur të pranohet në punë dhe i njejti fenomen po vjen në shprehje edhe tani. Kjo është katastrofale, për ne të rinjët të cilët po i kryejmë shkollat dhe nuk po na ofrohet mundësia e njejt e punësimit, dhe ndaj këtij fenomeni duhet luftuar e ne, si VV, jemi plotësish të brengosur me gjendjen e këtillë. Për këtë, duhet seriozisht, të brengosen pushtetarët të cilët duhet të inicojnë masa. Kur flasim për shifrat, mund të themi se numri i nxënësëve, 3-4 viteve të fundit, ku kemi 872 nxënës më pak, ndërlidhet me situatën ekonomike dhe politike të cilën e përmenda e atyre që nuk po u jepet hapësirë për t'u punësuar, por kërkojnë mundësi në vende tjera. Kur flasim për raportin nxënës-mësimdhënës, në vitin 2014 kemi pasur 13 nxënës e tani, sipas raporteve që kemi, ai raport është 11

nxënës për një mësimdhënës dhe ky ritëm po vazhdon edhe më tej, që parqet katastrofë të madhe për komunën tonë.

z.Veliid Haxhisin- Më vjen mirë, që për herë të parë gjatë mandatit tim të të gjatë si delegat në Kuvend, po e miratojmë një Plan të këtill dhe dëshiroj të falënderoj dhe lëvdroj DKA-në i cili ka hartuar një Plan të këtill i cili mjaft premton, nëse realizohet plotësisht. Këtu janë përfshirë potjhuaj se të gjithë faktorët të cilët ndikojnë në arsim e unë do të theksoj vetëm disa gjëra të cilat i kam vërejtur në kuptim të gabimeve teknike-gramatikore. Në fq.42 pika 24 në tabelën 4 qëndron se Komuna ndan, për çdo vit, nga 300,00 euro e në tabelë qëndron 3 mijë euro, ndoshta, ky është gabim teknikë me rastin e përkthimit e që do të ishte mirë të përmirësoshet. E dyta, që dëshiroj t'a theksoj dhe pyes drejtorin e DKA-së janë trajnimet që janë paraparë për mësimdhënësit tonë se ado të janë me certifikata dhe se e do të pranohen nga MASHT-i, meqënëse, herë pas here, mësimdhënësit po kanë probleme me rastin e aplikimeve për licencim e që kërkohen me rastin e aplikimeve. Në fq.9 qëndron, e që e kam theksuar edhe dje në KKomitite, është çështja e përdorimit të gjuhëve "bosnjake-bosnjakisht" e që, ndoshta, qëndron mirë në gjuhën shqipe, por në gjuhë e komunitetit duhet të qëndron "gjuha bosnjake" e këto çështje duhet pasur parasysh dhe koriguar.? Megjithkëtë, dëshiroj që këtë Plan t'a përkrahim dhe t'a zbatojmë maksimalisht.

z.Naser Myrtezani- Edhe ne si delegatë, të subjektit tonë politikë (LDK-së), kemi vërjetjet tona në Planin e Asimit dhe se ne nuk jemi kundër tij, por kundër anëtarëve të Ekipit -Komisioniti cili ka punuar në këtë Plan? Këtë po e theksoj nga arsyja se ne i kemi parë dhe lexuar emrat që gjenden në këtë Plan që janë emra të militantëve partiak dhe që e kanë përkrahur partinë politike në pushtet, nga se janë emra që kurr nuk kanë pasur çasje në arsim dhe nuk kanë sot kurfar lidhje me arsimin dhe procesin e arsimit? Këto janë vërejtjet tona konkrete në këtë Plan të Arsimit, sepse janë përfshirë të atillë që nuk kanë asgjë me arsimin dhe as që kanë kapur ndonjëherë ditar në dorë, apo orë mësimore. Dëshiroj t'i parashtroj pyetje drejtorit se sa janë paguar këta njerëz, sa u kanë qenë mëditjet dhe kush i ka përgjedhur? Këtu shihet qartë se sa është i arsyeshëm ky e të gjithë ne e dijmë se sa është i nevojshëm një Plan i këtill, pasi se unë, personalisht, jam punëtor i arsimit dhe e dijmë se si është gjendja në shkolla e sidomos gjendja fizike e objekteve shkollore e cila është katastrofale, duke filluar që nga Zaplluxhja e deri në Restelicë. Po theksoj se mungon letra e bardhë, shkumsat, apo edhe sfungjerët?! Prandaj, sa do të ndikon ky Plan në përmirësimin e gjendjes në arsim ngel të shihet, pasi se jemi mjaft skeptik për këtë gjendje. Po e shfrytëzoj rastin që y Plan të vehet në funksion dhe ftoj drejtorin e DKA-së që mekanizmat e tij t'i ven në funksion, që gjendja nëpër shkolla të rregullohet. Më besoni se, në fshatin tim Zaplluxhe dhe në shkollën e Bresanës ku jam punëtor, edhe po të doni nuk mundeni të shkruani për të lexuar nëpër tabelë të shkollës?! Për këtë që theksoj, në atë shkollë kemi mjaft punëtorë, që mund të pyeten lirisht, nëse dikush dëshiron të më demanton? Në fshatin Xerrxe kemi shkollën e cila sa s'është shembur e ne këtu po bëjm dofar plane për arsimin e në fshatin Zaplluxhe kemi shkollën ku nuk është investuar asnjë cent?! Kjo është mëkat, edhe pse kemi nevojë për Planin e këtill, por është mjeruese pse janë angazhuar personat jo adekuat për këtë punë, kur dihet se nga sektori i arsimit kemi njerëz profesionistë të fushës së arsimit dhe ka qenë mundësia që të angazhohet nga një mësimdhës i shkollave e jo të angazhohen persona që nuk lidhje dhe vizion me arsimin?! Parashtrohet pyetja se si mund të hartojet një Plan i Zhvillimit të Arsimit kur gjithçka funksionon në baza politike e rasti konkret është Konkursi i hapur për 2 venede pune në Zaplluxhe- Zgatar,

pasi se qe 13 muaj nga puna e kryetarit aktual, nga këto fshatra, nuk punësua askush, as në arsim apo lëmi tjera dhe se Zaplluxha po është "zorrë e verbër" sa i përket punësimit e ky është rast më komplet i ndikimit politikë e kjo ka qenë praktikë edhe e kryetarit të mëparshëm e që ju e keni vazhduar?! Jo vetë ajo se, kohëve të fundit, po punësohen personat që janë militantë apo simpatizantë të partisë suaj (PDK-së), por keni filluar të punësoni personat që janë në lidhje të ngusht familjare me ju. Kjo ka treguar se ju i keni zhgënjer votuesit tuaj që ju kanë votuar dhe, mos harroni se, në Zaplluxhe keni pasur vota dhe nuk keni kaluar keqë, por që tanë po shifet se sa keni menduar për këtë fshat dhe, lirisht mund të thuhet se keni averzion ndaj anëtarëve të LDK-së dhe të fshtrave, ku kjo parti ka fituar shumicën e votave. Tani e keni treguar fytyrën e juaj të vërtetë se kush jeni dhe se si po silleni ndaj partive tjera politike?!

**z. Refik Latifi**- Reth kësaj pike nuk do të ndalem, nga se folën kolegët parafolës. Por, kam një sugjerim lidhur me këtë Plan dhe atë te pjesa e kulturës dhe ambienti shkollor, ku në fq.25 thuhet se orjentimi i komunës do të jetë në mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese, si dhe në ndërtimin e terreneve sportive, stadiumeve dhe aktiviteteve të ndryshme sportive, ndërtimin e terreneve sportive dhe në gjelbërimin e hapësirave shkollore, sepse në këtë mënyrë do të përmbyshen standartet themelore të shkollave e që do të ndikohet në cilësinë mësimore. Unë, me këtë, nuk pajtohem, te pjesa e cila i përket cilësisë mësimore, pasi se ambienti nuk mund të ndikon në cilësi mësimore?! Sa i përketë cilësisë mësimore këtu ndikojnë trajnimet e mësimdhënësve, aftësimi profesional i tyre e kjo që qëndron në Plan nuk ka të bëj fare me cilësinë mësimore, por do të ndikohet në ambientin shkollor. Një element tjetër me rëndësi që do të theksoja është siguria në shkolla e sidomos në shkollat e mesme dhe roli i DKArsimit në këtë fushë e që duhet të jetë çështje esenciale. Si konkludim, mund të them se autorët e këtij Plani është dashur të flasin për sigurinë nëpër shkolla, pasi se siguria është faktor tejet i rëndësishëm për një atmosferë normale pune në objektet shkollore.

**z. Nexhat Isufi**- Fillimisht, ju dëshiroj punë të sukseshme në këtë ambijent të ri pune, që llogaris se do të kemi, s'shpejti, edhe nxemjet e zërimin. E përvendos këtë Plan Zhvillimor të Arsimit te ne dhe, me sa e dij unë, për herë të parë, kemi një Plan të këtill në Kuvend e që është Plan afatgjatë i cili tregon rrugët nëpër të cilat duhet të kalon shkollimi. Duke i pasur parasysh investimet e deritashme në arsim dhe shkolla, mund të them se, në mënyrë gjenerale, është një punë e mirë-e hartuar në letër e që duhet të përbushet duke u vu në funksion e kjo i përket DKA-së dhe shkollave me cilësi më të madhe mësimore në të ardhmen. Në f.10, përfshihen statistikat nga viti 2012 e ne tash më po shkojmë kah viti 2020 e që nevoitet të kemi statistikat më të reja e aty thuhet se, reth 45% e nxënësëve që përfundojnë vitin e nëntë, nuk regjistrohen në shkollat e mesme e këtë nuk duhet zhagitur, por duhet dhënë kontributin tonë, që nxënësit mos të na shkojnë në shkolla tjera, jaشت komunës sonë. Po ashtu, si prioritet, që duhet të përfshihet në këtë Plan, përmendet se nëpër disa fshatra kemi dy sisteme të arsimimit e ne dijmë se jemi një shtet, që le të kuptohet se diçka nuk është në rregull?! Këtë e dijmë të gjithë dhe nuk po u japim prioritet çështjeve, që nxënësit tonë mos të mësojnë dy histori të ndryshme?! Ne kemi dy sisteme të arsimit dhe ai sistemi tjetër nuk është ai i Kosovës, por i historisë serbe dhe si mund të ngjan kjo në Komunën tonë, ku nuk kemi asnjë Serb?! Ai qytetar, i cili mëson një sistem tjerë e nuk punon me ligjet e Kushtetutën e Kosovës, si mund të jetë i barabart me ne dhe çka bënë DKA-ja, kur duihet se një mësimdhënës punon me sitemin tjetër arsimor e madje merr paga nga dy buxhete-Kosovës dhe Serbisë?! Se sa ka të tillë, unë nuk e dij, por ka mësimdhënës të tillë! Çështja tjetër është se si të ndalohet kjo

gjendje, kur dihet se me buxhetin e Komunës sonë-Kosovës shfrytëzohet nxemja, inventari e gjithçka tjetër edhe nga mësimdhënësit e sitemit tjetër arsimor-serb dhe me histori serbel Për këtë, duhet të ketë qëndrime të qarta dhe jam përkrahje të këtij Plani, por të na sillen raporte të reja vjetore për realizimin e tij dhe të shifet se ai është afekstiv e që edhe ne të japim kontributin tonë, si delegatë.

z.Samidin Xheladini- Edhe unë, sikurse të gjithë delegatët, dëshiroj të ja kontributin lidhur me këtë Plan të Arsimit në Komunën tonë dhe, sa i përket arsimit, mund të lëvdërohem i dhe të turpërohem. Lëvdrimet u përkasin atyre të cilët jepin kontribut maksimal në avansimin dhe përparimine gjeneratave tona në arsimim. Mjerisht, në këtë lëmi kemi edhe papërgjegjësi të një numri personash të cilët nuk e jepin kontributin, sa dhe si duhet, pasi se menquria shfrytëzohet 10% e ne e dijmë se si vlerësohen mësimdhënësit tonë që po na marrin në qafë të gjithë neve e më të mirë janë ata që vlerësohen me notat më të larta. Pra, ata që angazhohen për mësimin e nxënësëve tonë, janë të dëshirueshëm e ne me rastin e testimeve kemi parregullësi, pasi se intervenimet na kanë ra në qafë si shoqëri, dhe në vend që të kemi përparim po kemi rënie të nivelit të arsimit, edhe pse është tentuar të përmirësohet niveli. Në këtë Plan janë paraparë disa masa nga hartuesit e tij për arsimim më cilësor dhe ambient më të mirë shkollor me kurikulin e ri dhe aftësimin arsimor me qëllim të përmirësimit të performancës në arsim. Si mision përmendet përmirësimi i suksesit dhe punësimi përmes miratimit demokratik të vendimeve, etikës dhe përmirësimit të përdorimit të gjuhës letrare nëpër shkolla, kurse, parimi, përmendet edhe transparenca dhe llogaridhënia e përgjegjësia. Në këtë kontekst, përmendet integrimi dhe respektimi i kodit etik dhe konfidencialitetit, veshjes dhe parimi arsimimit profesional gjatë tërë jetës. Këtu përmendet edhe buxheti në shumë prej 663 mijë euro, ku një pjesë do të finansohet përmes Grantit Qeveritar e një pjesë nga të hyrat vetanake dhe donatorët Ajo që është shqetësuese është se, nga numri i tërësishëm i nxënësëve, 690 nxënës kanë vazduar shkollimin e mesëm që është 45% nga ata që vijojnë mësimet te ne. Po ashtu, parashihet që komuna jonë të ketë më 2019 edhe një fond prej 3,3 milinë euro. Te kategoria e masave, sukseseve dhe dobësive, mua më brengos mos plotësimi i 3 vendeve pune në DKA? Në anën tjetër, theksohet se edhe shkollat kanë planet e tyre zhvilimore, por që ata janë formal dhe pa analiza të duhura në nivel komunal. Ndërkaq, në fq.14 përmendet se 43% e nxënësëve nuk e kanë kaluar testin e që është shqetësuese, siç përmendet edhe në fq.15 mos vlerësimi i performancës lidhur me cilësinë e zgjedhjes së mësimdhënësëve dhe drejtoreve të shkollave, pastaj ndikimet politike etj. Përmendet edhe ajo se, në Komunën tonë funksionojnë 36 objekte shkollore dhe 12 shkolla amë, 1 shollë e mesme dhe 26 parale mësimore, apo mos është kjo gabim? Brengos edhe ajo se kemi paralele mësimore madje me nga 1 nxënës?! Përmendet edhe pjesëmarrja nëpër punëtori të aftësimeve e që, prap, ka vështirësi në zbatimin e kurikulit të ri në arsim?! Te mungesa e mbikqyrjes përmendet edhe koordinatori i kurikulit, bashkëpunëtorëve për kapacitetin e mësimdhënsve të cilët do të ndikonin direkt në shtimin e kapaciteteve në aspektin e kurikulit. Përmendet, po ashtu, edhe mungesa e informatave reth zgjedhjeve të drejtoreve e që DKA-ja nuk paska pasur çasje?!

z.Vehbi Nazifi- Plani Zhvillimor i Arsimit është voluminoz dhe autorët janë munduar të përfshijnë gjërat, duke filluar nga gjendja ekzistuese në tërës e deri te qëllimet që duhet të realizohen. Por, më pengon fakti se pse, nga autorët, nuk është përfshirë, në klasët e ulëta, mësimi gjithditor i cili sistem aplikohet në tërë Europën e që nuk paraqet risi, pasi se është formë e cila mund të aplikohet e kjo të jetë, si një vërejtje, e që do t'i kisha propozuar drejtorit, si në formë eksperimenti, të tenton implementimin e

këtij mësimi. Kjo, me siguri se, do të ndikonte nlë cilësin e arsimit. Sa u përket duiskutimeve të kolegëve, ato nuk ishin në drejtim të dhënies së porpozimeve, por që kishte kritika në punësim e jo dhënien e kontributit për zhvillim të arsimit. Te punësimi, është e vërtetë se të gjithë konkurojnë dhe nuk e besoj se te ne, në arsim, punësohen ata që nuk janë të kualifikuar, pasi se, shumica e kandidatëve, e vijnë me diploma përkatëse dhe psh. nuk mundë të jep gjuhë angleze personi me gjuhë shqipe e sa i përket cilësisë kjo nuk mund të dihet, pasi se secili e ka diplomën? Për punësimë ekzistojnë komisionet të cilat vlerësojnë cilësin e kandidatëve. Këtë që po theksohet këtu e theksojnë edhe partitë opositare lidhur me punësimet, se po punësohen kandidatët a partisë në pushtet dhe votuesit e tyre. Mundësitë janë të tilla që të pnësohet vetëm një kandidat përmes konkursit të publikuar dhe është normale se nuk mund të kënaqen të gjithë, me rezultatet. Po ashtu, çështje mjaft e ndieshme është ajo e institucioneve paralele në arsim dhe do të ishte mirë që këtu të jasin kontributin kolegët tonë, që ky sistem paralel të kyçet në sistemin e rregullt të arsimit. E dij që kjo është çështje politike, por mendoj se mjaft është bërë lojë me fëmijët dhe duhet të jasin të gjithë kontribut, që fëmijët tonë t'i kthehen sistemit të rregullt të arsimit te ne.

z.Sefidin Mejzini- Nuk është ngarkesë nëse e diskutojmë gjatë këtë Plan Zhvillimor të Arsimit, pasi se është fjala për Plan 4-vjeçar. Sa i përket Planit nuk ka ndikime politike dhe është i mirëseardhur, por kur është në pyetje zbatimi, këtu ka pengesa dhe janë të njejtë persona që e bëjnë edhe punësimin?! Te shkollimi i mesëm, unë jam mjaft i shqetësuar, pasi se do të kemi raste të dërgimit të fëmijëve në polici, gjykata e që nuk duhet të ngajn? Pra, po harrohet se këtu nuk kemi të bëjm vetëm me sistemin e arsimimit, por me sistemin edukativ-arsimor dhe se ekzistojnë njerëz që janë pedagog të mirë, por ka edhe të atillë që nuk janë fare pedagog e që ligjerojnë?! Është tejet shqetësuese dhe janë disa çështje për kompetentët, pasi se përmenden 5 terrene sportive, a janë të cakuar, ata apo do të caktohen më vonë e sipas nevojave, pasi se dhe këtu e kemi atë ndikimin politikë? Ne jemi rival politikë dhe, pa keqëkuptime, ne jemi këtu që të ju orjentojmë e përmirësojmë gjendjen? Ekziston një kontrast dhe kemi parë se, disa shkolla, do të furnizoheni me "lap-topa", që do të thot se mësimdhënësit kanë mundësin e qasjes "online" të arsimit e që tani ka ardhur vendimi për (mos) përdorimin e telefonave mobil e që paraqet kontarst me këtë Plan Zhvillimor?! Në fq.35, te punësimi i zyrtarëve, qëndron në vitet 2020-2022 e pse nuk është 2019-2020? Me siguri se për këtë ka përgjigje?

z.Munir Jonuzi- Shoqëria bashkëkohore është shoqëri e diturisë dhe paraqet parakushte për zhvillimit të arsimit. Komuna e jonë u takon 8 komunave në Kosovë të cilat kanë hartuar këtë Plan i cili është gjith përfshirës dhe dihen sfidat me të cilat ballafaqohemi në procesin mësimor. Shprej se shkollat do të paisjen edhe dokumentacion pedagogjik dhe se, ai dokumentacion, do të përkthehet edhe në gjuhën e jo shumicës. Është mirë edhe ajo që, secila shkollë do të ketë Planin e vetë Zhvillimor i cili, me siguri, do të harmonizohet me Planin Zhvillimor të Arsimit të Komunës. E falënderoj drejtorin e DKA-së dhe pushtetin ekzekutiv të Komunës që kanë mundësuar organizimin e seminareve dhe trajnimeve të ndryshme për mësimdhënës, për për mësim sa më cilësor dhe efikas. Shpresoj se të gjitha shkollat do të kyçen në kurikulin e ri dhe se Drejtoreti do të vazhdon me praktikën e organizimit të seminareve të reja, kurse, sa u përket kompetentëve në hartimin e këtij Plani, mendoj se autorët kanë qenë kompetent dhe të njojur me metodat e reja bashkëkohore që mund të kontribuohet në zhvillimin e mëtejme të arsimit.

Kryetari-Ju falënderoj për diskutimet e sugjerimit dhe theksoj se në bazë të bisedave dhe konsultat me ekspertët është ardhur në përfundim se ky Plan është mjaft sfidues për Komunën tonë, sidomos te pjesa e cila kërkon implikime buxhetore, nga viti në vit. Ate që duhet t'a kemi në dijeni është se jemi mirënjojës se sot kemi një Plan të këtill, me anët e mira dhe të jkëqija të tij dhe, si i këtill, do t'u shërben edhe të tjerëve, si urdhrrëfim për proceset arsimore. Pa dyshim se e pranojmë gjendjen momentale faktike dhe me rëndësi është të jemi pjesë e këtij Plani, pasi se tham se, edhe komunat më të mëdha kanë plane të këtilla, kurse ne kemi fatin që jemi ndër komunat e vogëla, që të kemi Planin e këtill arsimor. Sa u përket implikimeve buxhetore, do të veprohet aq sa mundemi, nga se ne tash më e kemi miratuar buxhetin për këtë vit e që duhet të angazhohemi me implementimin e tij në vitin e ardhshëm. Ajo që doli si brengë gjatë diskutimeve është çështjka e zvogëlimit të nxënësëve, që kjo dukuri kërkon analiza më detalete se pse është kështu? Po ashtu, u theksua se nga numri i nxënësëve varet edhe numri i mësidi-hënësëve që janë të angazhuar e do të angazhohen. Sa u përket gabimeve tekniko-gramatikore, mendoj se kjo duhet të merret parasysh në tekstin final të Planit, siç theksoi edhe kolegu Velid H. lidhur me gjuhën boshnjake. Ajo lidhur me mungesën e kushteve nëpër shkolla, përfshi këtu edhe mungesat teknike-me tabela apo edhe sfungjera e shkumësa, është mirë që u theksua, nga se secila shkollë shfrytëzon në mënyrë të pavarur mjete të caktuara për këtë qëllim, kurse interevenimet tjera teknike do të shqyrtohen vazhdimisht, në bashkpunim me drejtorit e objekteve shollore. U përmendën edhe konkurset e punësimit në arsim e këtu secili ka të drejtë të ndaj dhe jep mendimin e vetë dhe jam i vetëdijshëm se këtu nuk jemi më të mirët, por mendoj se është vepruar në kadër të regulativave ligjore gjatë procedurave të rekrutimit. Z. Refik L. përmendi një fakt lidhur me ambientet shkollore që do të ndikonin në cilësin mësimore, kjo është në rregull nëse është fjala për mbajtjen e lëndëve në ambient të hapur, kurse nëpër disa shkolla jemi në procesin e rethimit të shkollave me rethoja e që do të ndikonin në sigurinë në shkolla, siç janë edhe vendosja e kamerave të sigurisë në disa nga fshatrat tona. Ndërkëq, përsigurinë në shkolla përgjegjësisnë më të madh e kanë drejtorët e tyre si menaxhues të objekteve shkollore. Z. Nexhat I. përemndi informimin vjetor për gjendjen në shkolla nga menaxherët e tyre dhe DKA-ja për realizimin e këtij Plani e që edhe unë ndaj një mendim të tillë. Ndërkëq, sa i përket sistemit të arsimit, mendoj se edhe diskutimit e sotme i kontribuojnë integrimit të të gjithëve, për përmirësim të mësimit, përfshi këtu edhe angazhimet për arsimim të unifikuar me plan-programe mësimore, pasi se, është koha e fundit, që kjo çështje të zgjidhet. Angazhime me kohë do të ketë edhe lidhur me furnizimin e shkollave lëndë djegëse si dhe përzgjedhjen e drejtorëve sipas dispozitave ligjore në fuqi e që do të ketë edhe një UA të ri nga MASHT-i e që këtu, në kuadër të Panelit, do të kyçen edhe përfaqësues të Këshillit të Prindërëve e që mbetet të shifen rezultatet, pasi se, si duket, edhe MASHT-i e ka hetuar se përzgjedhja e tyre nuk po shkon si duhet. Në nanën tjeë, sa u përket ndërtimit të stadiumeve apo sallave sportive në shkolla, pos anës materiale, këtu nevoitet të merren parasysh problemet pronësoro-juridike që mund të na paraqiten si pengesa në realizimin e këtyre dëshirave e nevojave nëpër shkolla. Me Plan parashitet edhe kompletimi i stafit në DKA e kjo do të ndodh sipas nevojës që kërkohet me Plan e në funksion të kompletimit të statfit adekuat. Lidhur me kompenzinë e anëtarëve të GP që punuan në këtë Plan, po theksoj se është vepruar sipas rekomandimeve të ekspertëve të kësaj lëmie dhe po theksoj se, asnjëri nga anëtarë e Grupit, nuk është komepnzuar dhe gjithçka është punuar në baza vullnetare dhe në kaudët të obligimeve të punës, që besoj se edhe Ju do t'a pranoni këtë Plan Zhvillim të arsimit te ne.

z.Samidin Xheladini- Siç theksuam, ne (LDK-ja) e përkrahim parimi shqiptar këtë Plan. Por, dobësit të cilat i ka përcaktuar edhe vetë Komisioni, janë vërtetë të tilla e këto janë prezantuar edhe në dokument dhe, nëse këto çështjet nuk i adresojmë si duhet, nuk do të kemi sukses. Në fq.14 është fakt ku thuhet se DKA-ja e ka dhënë bazën e shënimave e që testet e të arriturave jashtë suksesit të mëdha të nxënësive, kurse provimi i maturës, në afatin e parë të mbajtur në qershor 2018, ka treguar se mbi 43% e tyre nuk kanë kaluar?! Pra, kjo do të thotë (mos) që e mësimdhësive e që është përfshirë me statistikë?! Po ashtu, në fq.15 theksohet se notimi i performancës së mësimdhësive dhe drejtoreve të shkollave është mënyrë e zgjedhjes së mësimdhësive, por ka pasur ndikime politike etj. e kjo është e vërtetë, pavarësisht se kjo i pëlqen apo jo dikujt e ky është realiteti. Pra, ne e përkrahim këtë Plan, por pyetjet e mia adresohen ashtu që të zgjidhen nga kompetentët dhe, të gjitha vërfjet e kolegëve që u than janë me vend, edhe pse njëri prej tyre theksoi se ka pasur rastin të shef në Plan shumë më të mirë të një komune tjetër.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është për miratimin e këtij Plani Zhvillimor të Arsimit, për periudhën 2019-2023...? 23 "për", 1 "kundër" djhe 1 votë e "përbajtur", që kosntatojmë se emiratuam këtë Plan.

#### Pika e III-të (trerë) e rendit të ditës

Në kuadër të kësaj pike të III-të kemi :Shqyrtimin dhe miratimin e P/Rregullores për ndryshimein dhe plotësimin e Rregullores së Lartësisë së Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale, që fillimisht, fjalën e ka z.Valon Shabani (drejtor i DEFInanca)- Në bazë të iniciativës së kryetarit dhe neve si Drejtorat e kemi hartuar këtë P/Rregulllore, për të vazhduar praktikën e mirë në komun tonë për lirimin nga taksa të bizneseve që janë të regjistruar në intervalin kohor, siç qëndron në P/Rregulllore. Meqenëse ndodhemi në një zonë gjeografike, e ku janë qendra e largëta e që nuk kemi përkrahje biznesore përmes subvencioneve, e kemi propozuar këtë P/Rregulllore që, sado-kudo, t'u lehtësohet puna dhe veprimtaria e bizneseve, përmes (mos) pagesës së taksës komunale. Psh. nëse një biznes duhet të paguan 80,00 euro në emër të taksës komunale, për një vit përfundim, kjo P/Rregulllore ia mundëson që këtë mos t'a paguaj, përmes lirimit nga ajo. Delegatë më të vjetër e dijnë se kjo Rregulllore, për herë të parë, është miratuar më 2012 e deri më 2016-2018, nga dy vite, që tani ka kaluar afati i saj dhe që tani e kemi në rend dite të njejtën P/Rregulllore, për t'u ndihëmuar e përkrahur bizneset tona.

z.Samidin Xheladini- E përvihendës këtë P/Rregulllore, duke pasur parasysh se, një numër delegatësh, nuk e ka ate, pasi janë zgjedhur tani e që do të ishte mira t'a kishin. Por, pasi se kryetari theksoi se ajo do të ndryshohet në tërësi-në rregull, kurse, nëse nuk ndryshohet, t'u përcillet delegatëve të rinjë, si Rregullore-në tërësi.

z.Velid Haxhisin- Kjo paraqet lehtësim për bizneset tona private dhe është mirseardhur dhe unë do të ndërlidhem me ndryshimet, pasi se ajo nuk është e definuar mirë te neni 6 i saj, pasi se nëse e miratojmë, si të këtillë, do të jemi të pa drejtë ndaj bizneseve të tjera që do të regjistrohen, siç është theksuar. Psh. nëse një biznes regjistrohet në muajin Shkurt e tjetri në Nëntor 2021, kjo do të thotë se ata nuk i kanë të drejtat e barabarta? Për këtë, propozoj që të shtohet se lirohen për 3 vitet e ardhëshme të veprimtarisë së tyre. Pra, do të thotë nga dita e aplikimit për regjistrim të firmës e deri në 3 vitet veprimtari?

z.Vehbi Nazifi- Kjo P/Rregulllore është e mirë dhe mendoj se gjithësesi do t'u ndihëmoj bizneseve. Por, ngjan që, disa nga bizneset t'a keqpërdorin, pasi se i shfrytëzojnë vendet publike dhe lokalitetet që nuk duhet t'i shfrytëzojnë e me këtë po e pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve, shfrytëzim jo legal të trotoareve, parkingjeve dhe vendeve tjera publike. Shpesh-herë ngjan se, sidmos gjatë sezonit, i vendosin tavolinat e tyre në trotoare dhe shfrytëzojnë hapësirat publike, pa kurrfar kompenzimi, dhe pengojnë qarkullimine e lirë të qytetarëve. Po ashtu, edhe një brengë e cila i përket tregut javaor në Bresanë, pasi se aty bëhet një e pa drejtë ndaj bizneseve lokale që janë të regjistruar legalisht dhe paguajnë tatime, kurse biznesmenët-shitësit ambulantiv po vijnë, me kamionët e tyre, dhe shesin mallin para shitoreve të tyre e që, faktikisht, po vjen në shprehje konkurrenca jo lojale ndaj bizneseve legale.

z.Valon Shabani- Po theksoj se Rregullorja, si tërësi, mund të gjendet në web-faqen e Komunës dhe atë e vitit 2014, si dhe ajo e vitit 2016-me plotësim. Përt shkak se materiali është i gjerë, nuk kemi mundur t'a dërgojmë materialin, në tërësi, por që mund t'a shkakrkojnë nga web-faqja kommunale. Sa u përket pyetjeve të parashtruara nga ana e delegatëve, mund të them se, s'shpejti, do të hartojmë Rregulloren e re - në tërësi, që do të aplikojmë procedurat e nevojshme përmes tubime publike, me pjesmarrjene qytetarëve dhe delegatë e Kuvendit.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është për miratimin e kësaj P/Rregullore...? 24 - "për", 0 vota "të përbajtura" dhe 0 vota "kundër", që konstatojmë se miratuam këtë P/Rregullore...

#### Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e IV-të radhës ku kemi plotësimin e Komisionit për dhënen në Shyfrtëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale. Por, para se të kalojmë në te, po Ju njoftoj se nga kompetentët e një Qendre, përkatësisht OJQ e Policia, do të kemi një temë për t'u njoftuar-ligjëruar e ajo ka të bëj me radikalizmin i cili kalon në terrorizëm, që do t'i kisha lutar delegatët, që pas, përfundimit të pikave tona të seancës, të qëndrojnë në sallë, për të dëgjuar ligjëruesit e kësaj teme. Vazhdojmë me pikën e IV-të radhës, që, për sqarime, do të na njoftoj kryetari Shaban Shabani- Ka nevojë reale të bëhet një plotësim në këtë Komision të Kuvendit, meqenëse anëtarë deritashëm i tij-z.Ramadan Krasniqi, nga ekzekutivi i Komunës, është i ngarkuar me punë tjera, të bëhet zëvendësimi tij, që, konkretisht, propozoj z.Eqrem Rahmani, zyrtar në DUrbanizmit, prap, në emër të ekzekutivit të Komunës e që përbërja e Komisionit ngel e njejtë-7 anëtarë.

Kryesuesi- Në rregull, mendoj se nuk kemi nevojë të lëshohemi në diskutime dhe kalojmë në votim dhe kush është për këtë protësim...? 24 – "për", 0-“të përbajtura” dhe 0-vota “kundër”, që konstatoj se e bëm edhe këtë plotësim të këtij Komsioni.

#### Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës – “eventuale”...

Kalojmë në pikën e fundit-“eventuale”, hapim diskutimet...

z.Nexhat Isufi- Unë dëshiroj të flas lidhur me punën e këtij Komisioni që e plotësuam tani. Siç dihet, ky Komision, tani shpejt, ka pasur një Ankand Publik i cili ka qenë i formës së mbyllur-përmes zarfeve dhe a është këtu dikush nga anëtarët e këtij komisioni, për të na informuar? Në atë Ankan Publik, disa nga

qytetarët dhe firmat kanë konkuruar dhe disa nga ato prona janë dhënë në shfrytëzim e, në fakt, fjala është për disa lokale të Komunës dhe tregun e gjelbërt dhe parkingun. Në web-faqen e Komunës, unë e kam lexuar një Njoftim të Komisionit e ku janë fituersit e Ankandit, që dëshiroj të më njofton dikush lidhur me dhënien në shfrytëzim të tregut të gjelbërt se ka pasur ofreta prej 800,00 eurove, kurse në Noftim na del se i është dhënë dikujt për 275,00 euro dhe si ka ardhur deri te kjo?!

**z.Veliq Haxhisin-** Unë, shkurtimi shkurtimi, do t'i drejtorhem drejtorit të Shërbimeve Publike, por që edhe kryetari mungon e që besoj se do të lexon Procesverbalin? Fjala është për mirëmbajtjen e rrugës, apo pastrimin nga bora e cila qonë kah vendi ku në Restelicë ka ndodhur tragjedia para disa viteve e që fjala është për gjatësei prej afro 2 km. e që e kemit heksuar se do të mirëmbahet dhe, mos e dhasht Zoti, që të na ndodhën, prap, diçka e ngajshme atje? Ka qe disa vite se nu kpo i kushtohet vemendje kësaj çështjeje e ne kemi format e mirëmbajtëse të rrugëve dhe kërkoi që, edhe kjo rrugë, të përfshihet në mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve tona lokale. Për këtë, e kisha lutar kryetarin dhe drejtorin e këtij Drejtorati, që më seriozisht, të merren me këtë çështje, pasi se mendoj se nuk është në rregull që, nejrëzit të cilët janë ballafaquar njëherë me një tragjedi, të ballafaqohen prap me ate, pasi se nuk do të janë në gjendje as të mbërrijnë tek ambulanta e fshatit, në raste nevoje?

**z.Sefidin Mejzini-** Kemi mjaft brenga nga qytetarët të adresuara në DEmergjensës e që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror. Siç tha edhe kryetari, sivjet mirëmabitja e rrugëve gjatë dimërit, i është besuar kompanisë fituese të tenderit e që kemi pritur të jetë serioze e që ngjau e kundërt?! Sepse, po të lehen 15 fshatra në mëshirën e Zotit, është e tepërt. Askush nuk pret nga Kuvendi Komunal të hapen fabrika për t'u punësuar 300-400 punëtorë, por kërkojnë që të kryen obligimet që ka e ato janë nevojat elementare të qytetarëve e mos të bëhet hajgare, duke i lënë 15 fshatra në mëshirën e një traktori?! Performance e Komunës është pasqyrë e gjendjes dhe Komuna duhet të mirëmban rrugët lokale me ofrimin e shërbimeve elementare qytetarëve. Dhe, s'di se, ju që jeni në pozita komunale, e keni lejuar këtë gjendje, duke i mirëmabjtur rrugët një traktor?! Kjo është zhgënjim për ju dhe një Komunë. Nuk mund të themi se kompania që e ka fituar tenderin është e dobët, por përkundrazi e fortë, dhe është dobësi për kompetentë pse nuk është bërë pastrimi i rrugëve, siç duhet?!

**z.Naser Myrtezani-** Edhe unë kam vërjetje lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve, pasi se ku më kanë takuar qytetarët, edhe përmes rrjeteve sociale e telefonave, disa herë, më kanë thënë dhe rekomanduar se duhet të angazhohemi reth mirëmbajtjes së rrugëve lokale gjatë dimërit. Në rastet konkrete, kemi pasur fshatra të cilat kanë plotësish të bllokuara dhe se qytetarët kanë qenë të detyruar t'i hapin vetë rrugët nga bora, për të deblokuar fshatrat, deri në rrugët kryesore. Edhe sot e kësaj dite ka fshatra ku janë të hapura nga automjetet vetëm stazat e rrugëve, kurse unë, personalisht, kam kërkuar nga kryetari që rruga Zaplluxhe-Lez-Prizren të futet në mirëmbajtje dimërore apo tek zona kadastrale me Prizrenin, por që kjo nuk është marr parasysh, që ka detyruar fermrët që vetë t'i hapui rrugët deri tek fermat e tyre. Pyetja tjetër është për kryetarin i cili gjatë fushatës parazgjedhore. Në masë të madhe, ka premtuar punësimë të të rinjëve, me krijimine vendeve të reja të punës dhe do të parashtroj pyetjes se, nga intervali kur keni marr detyrën si kryetar, sa vende pune keni hapur dhe në cilët sektor? Edhe pyetja tjetër i përket fushatës parazgjedhore e për këtë keni ardhur edhe në Zaplluxhe dhe i përket hapjes së rrugës Zaplluxhe-Guri i Zi-Tetovë dhe ju dhe kryetari i mëparshëm këtë e keni premtuar?

z.Zinaida Elmazi- Kohë më parë, kemi pasur një takim me KDI-në e ku qytetarët kanë pasur kërkesa e njëri nga ato ka qenë ndriçimi i pjesës së poshtme të Dragashit, edhe pse ndriçimi i qytetit paraqet problem në tërësi. Për këtë, kisha kërkuar nga kryetari që të ndërmerren masa, që këto kërkesa të plotësohet edhe për nga aspekti i sigurisë së qytetarëve, pasi se shumë qytetarë shëtisin kah fabrika e mungesa e ndriçimit të rrugëve paraqet rrezik real?

z.Rexhep Kamberi- Edhe spe e trajtuam Planin Zhvillimor të Arsimit, për të cilin kishim vërejtje dhe lavadata, pyetja ime ka të bëj me PUrbaniq se kur do t'a ketë Komuna jonë e që është problem, por s'paku, të hartohet ai për qendrën komunale Për këtë kemi vlërtjte e ankesa të qytetarëve lidhur me ndërtimet pa leje apo dhënien në shfrytëzim të pronave e që parashtrohen para Kuvendit dhe organeve komuanle e që, shpesh-herë, i kërkojnë si kushte edhe donatorë nga qytetarët për ndërtime. Për këtë do të ishte të kishim edhe ndonjë Rregullore, nëse nuk është ndonjë e mërjhershme e cila nuk ka ardhur në shprehe deri tani.

z.Shpetim Hajredini- Kam disa kërkesa të cilat më janë paraqitur nga qytetarët. E para-si brengë ka të bëj me bizneset të cilat kanëardhur deri tek të dhënat se u qenkan shtuar faturat mujore për mbeturina e ne z.kryetar, vitin e kaluar, kemi mirauar Rregulloren për lehtësimë ndaj bizneseve e tan po kemi shtim të faturave për higjenë? Prandaj, duke pasur parasysh faktin se bizneset janë në pozitë të pavolitshme, çdo shtim i faturave do të ndikon negativisht në punën e tyre. Brenga tjetër që ma kanë shprehur është lidhur me kubëzimin e rrugët private e ju, para një viti, e keni miratuar një Vendim tlë till për mos kubëzimin e rrugëve nëpër prona private e që këtë e kanë theksuar edhe zyrtarët komunal, si qëndron çështja? Edhe një brengë tjetër, e që e theksuan edhe kolegët parafolës, ka të bëj me mirëmbajtjen e rrugëve lokale gjatë dimërit, pasi se gjendja, edhe pas marrjes së tenderit, ka qenë katastrofale në rrugët tona lokale e kjo nuk është në rregull, nëse kompania fituese e tenderit ka menduar se me 2-3 pastrime të kryen punën që duhet menaxhar vazhdimisht e që, si pasojë e kësaj gjendjeje kemi pasur pastrim të rrugëve edhe në baza vullnetare e kjo nuk është në rregull, nëse është anagzhuar kompania mirëbajtse e tyre?!

z.Zaim Hajredini- Kam dy pyetje e që njera u përfshi e ka të bëj me pastrimin e rrugës nga bora Zaplluxhe-Lez e cila është rrugë e re, si dhe rruga tjetër e re "Trokan"-Brrut e cila nuk mirëmbahet si duhet dhe, nëse këto rrugë nuk janë të përfshira, t'i përfshijmë me dokumentet tjera që nevoiten për mirëmbajtje të tyre, duke përfshi këtu edhe hartimin e ndonjë Rregullore të posaçme për këtë çështje?

z.Samidin Xheladini- Në Bresanë gjendja është shqetësuese lidhur me furnizimin me ujë të pijes dhe qytetarët i kanë harruar rrugët dhe problemet tjera, pasi se ballafaqohen me problemin e ujit të pijes, që disa muaj. Dëshiroj të pyes se a ekziston Plan Konkret për zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi se situata po përkallëzohet, duke kaluar edhe në konflikt ndrinjerëzor? Po ashtu, dëshiroj të ju njoftoj se ekziston problematika lidhur me aparaturën e cila ka arritur në QKMF për laborator e që po amortizohet e që po dërgohet në Krushevë aparaturë e re, ku ka më pak patientë, se sa në Bellobrad, edhe pse aparatura të tillë janë sjell, disa herë, e ne në Bresanë, ku kemi shumë nevojë e patientë, nuk kemi aparatura të tillë laboratorike dhe s'di pse është dërguar në Krushevë apartuarë e tillë? Kemi dëgjuar nga MShëndetësisë

se, të gjitha qendrat komunale, janë furnizuar me barëra, por që nuk i kemi vërejtur te ne, si qëndron çështja lidhur me këtë gjendje?

z.Nexhat Isufi- Lidhur me shtimin e çmimeve për mbeturina në biznese, nuk ka shtim të tyre, por e kemi Rregulloren e miratuar nga ky Kuvend e ku janë të përcaktuara çmimet dhe mos mendoni se biznesi i cili është marr me mashtrime, në emër të amvisërisë e që ka paguar 4,50 euro, sepse çmimi për mbeturina në biznese është nga 5-54,00 euro e në Rregullore shrkuante mirë se si dhe pçka paguhet. Pra, Rregullorja është e qartë se kush sa paguan dhe, kush dëshiron të paguan, ne të pagina e kush nuk donë të hedh mbeturinat në ambient të hapur, por të dini se nuk guxoni të gjuani mbeturinat jasht dyerëve tuaja hyrëse?!

z.Shpetim Hajredini- Mendoj se u keqkuptova se fjala ishte për brengën e shpehur nga bizneset dhe unë informata të sakta nuk kisha, pos asaj që është thënë se do të shtohet çmimi në 18,0 euro për një biznes e kjo, që arsyetuat ju, është çështje normale.

Kryetari- Do të mundohem të përgjigjем në disa nga pytjet e parashtruara. Siç dihet, ne kemi pasur procesin e Ankardin Publik dhe Komisioni e ka kryer obligimin e vetë. Me sa jam i informuar, janë publikuar rezultatet dhe ka pasur ofertues dhe konkurent e presim përfundimin e procesit, për shkak tli afit për ankesa. Dhe, siç dihet, ne e kemi edhe Komisionin për Ankesa, nëse do të ketë ankesa eventuale. Unë nuk jam pjesë e Komisionit dhe mund të mungojnë informatat detale. Pyetjet reth së cilave u bënë më shumë janë atë reth mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimërit dhe, siç jemi dëshmitarë, sivjet ka pasur më shumë të reshura dhe ka qenë pak sa më vështirë të menaxhohet situara dhe ne jemi munduar që, në kuadër të kapaciteve dhe mundësive tona, të jemi sa më afër qytetarëve për situatat që kanë qenë më emergjente, pa i lënë anash edhe të tjerat. Duke e pasur parasysh se, si Komunë, kemi paisje të amortizuara, për këtë arsyë edhe kemi shpallur tenderin e pastrimit të rrugëve tona lokale, përgjedhjen e kompanisë pastruese. Për këtë ka pasur vështirësi të mëdha, por me rëndësi është që fshatrat tona nuk kanë qenë të bllokuara, pasi se kompania pastruese ka anagzhuar edhe automjete shtesë për pastrim të rrugëve, si dhe na kanë dal në ndihmë edhe kompanitë tona private në baza vullnetare, që shfrytëzoj rastin t'i falënderoj publikisht. Në fakt, kjo ka qenë një praktikë e re, si për ne organet komunale, po ashtu edhe për kompanitë tona. Në këtë gjendje, më shumë kemi qenë të orjentuar në ato fshatra ku kanë pasur raste emergjente, pasi se kemi rastet se, nga disa fshatra, pacientët duhet të shkojnë në hemo-dializë, por që nuk janë lënë anash as fshatrat tjera e që do të janë parasysh nga kompania pastruese. Jam i vetëdijshëm se për këtë në gjendje, pasi se më të vështirë kanë qenë ato fshatra më perferike të Komunës e që gjendjen ka mundur t'a vështirëson edhe konfiguracioni i terrenit te ato. Edhe ajo që na gjzon, është fakti se gjatë kësaj periudhe kemi pasur pak raste të aksidenteve në trafik dher pa pasoja fatale. Sa i përket rrugës Zaplluxhe-Guri i Zi, sipas takimeve me organet kompetente në instanca më të larta, këtij aksi prioritet do t'i jep Komuna e Prizrenit, për t'u lidhur regjioni Prizren-Dragash-Tetovë dhe janë bërë analiza të caktuara, që besoj se instancat më të larta do të keni parasysh këtë nevojë dhe për vendkalim kufitar. z.Zinada E. parashtroi pyetjen lidhur me mbledhjet në fshatra përmes KDI-së dhe ndriçimit publik, që siç e dini, me buxhetin e këtij viti kemi paraparë një sasi të mjetave për këtë çështje, për të funksionuar më mirë kjo nevojë qytetare. Reth pyetjes së z.Rexhep K. për PUrbanistik, jemi në dijeni për rëndësin e tijë, por që ky proces është mifat i komplikuar dhe i shtrenjët.

Edhe më herët, ka pasur anagazhime, që s'paku, për Dragashin të rregullohet gjendja, kurse reth PU s'di se sa do të mudemi sivjet, kurse me hartimin e tijë do të krijonim mundësi më të mira për zgjedhjen e problemeve pronësoro-juridike. Lidhur me shtimin e çmimeve të pastrimit për biznese, mendoj se u dha përgjigja nga menaxheri i Kompanisë, por ndoshta ka mundësi që të mbahet një takim i përbashkët me përfaqësues të bizneseve dhe Kompanisë mirëmbajtëse. Lidhur me kobuzimin e rrugëve publike, që po përdoren edhe për private, ne e kemi në fuqi Vendimin i cili ndalon një praktikë të këtill, kurse kërkesa e z.Zaim H. për mbërmbjtje të rrugëve tjera përmes MInfrstrukturës-sikurse rrugëve të regjistruara, nuk është fjala për vetëm një rrugë, nga se kemi edhe rrugët, si ato për: Borje apo Shishtavec, por që ende nuk kemi konfirmime zyrtare për këtë, në të ardhmen. Rruja Brrut-“Trokan”, nuk është pastruar me kohë, nga se prioritet u është dhënë pastrimeve në fshatra, por që duhet pastruar nga se atje kemi edhe deponinë komunale të mbeturinave. z.Samidin Xh. foli lidhur me probelematikën e ujit në Bresanë e që është çështje shqetësuese edhe nëpër fshatra tjera e që, pas përmirësimit të motit, duhet ndërmarr masa të nevojshme përmirësuese, kurse lidhur me furnizimin e laboratorive me aparatura, jam në dijeni se ka arritur dhe mendoj se do të orjentohen aty ku kanë më shumti nevoja qytetarët, siç vlen kjo edhe procesin e furnizimit me barna i cili po vazhdon e për këto do të bisedojmë me kompetentët e shëndetësisë për zgjidhje sa më adekuat.

\*  
**z.Vehbi Nazifi-** Po ju drejtohem se, për shkak të angazhimeve të mia të mëtejme profesionale, kjo do të jetë seanca e fundit e Kuvendit për mua, që ju dëshiroj suksese të reja në të ardhmen dhe Ju falënderoj në përkrahje dhe Ju kërkoj falje, nëse dikend e kam ofenduar gjatë kohëzgjetjes së mandatit tim.

**z.Sefin Mejzini-** Në fund, më ngel borgj të përgjigjem se, lidhur me tenderin për Ankandin e fundit Publik, sa i përket “Tregut të Gjelbërt”, procedurat janë zhvilluar normalisht dhe fituesi ka qenë me 888,00 euro, por të gjithë janë tërhjekur, me kërkesa zyrtare, përfshi edhe ofruesin e çmimit më të lartë dhe ka ngel vetëm njëri-ai i cili e ka fituar Ankandin me çmimin që u cek nga parafolësi, që pra Komisioni (ku jam anëtar edhe unë) ka vepruar sipas regulave, madje duke ardhur në takime me shpenzimet personale.

**Kryesuesi-** Nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë pjesën zyrtare të seancës së Kuvebndit, duke vazhduar me ligjératën e paralajmëruar...

\* \* \*

Pas përfundimit të pikave të rregullta seancës, organizuar nga ATRC-ja dhe shoqata vendore SPRC, nga prof.dr.Xhabir Hamiti (moderator i takimit), nga z.Agim Musliu (ekspert i çështjeve të sigurisë) u lëgjéraua tema: “Identifikimit të radikalizimit të hershëm”, kurse nga z.Florim Shatrolli (nga Policia e Kosovës) tema: “Me demokraci pjesëmarrëse për një Kosovë pa radikalizëm”, të cilat tema u mirëpritën nga delegatët dhe të pranishëm tjerë.

**E përgatiti :**

**Shërbimi i Kuvendit Komunal**

**Kryesuesi:**

**Betim Merdiu**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

**LISTA**

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash  
Çlanova-delegata Skupštine Opštine Dragaš

Nr.seancës  
Br.sednice

17/2019

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	
2	Shpjetim Hajredini	PDK	
3	Xhemile Misinaj	PDK	
4	Artan Loshaj	PDK	
5	Vehbi Nazifi	PDK	
6	Granit Rifaj	PDK	
7	Suada Bajrami	PDK	
8	Sevim Avdullahi	PDK	
9	Elira Sulejmani-Krasniqi	PDK	
10	Samidin Xheladini	LDK	
11	Refik Latifi	LDK	
12	Sefidili Mejzini	LDK	
13	Naser Myrzekani	LDK	
14	Arijeta Skeraj	LDK	
15	Aida Misini-Halimi	LDK	
16	Adelisa Krasniqi	LDK	
17	Veljid Hadžisin	Vakat	
18	Munir Jonuci	Vakat	
19	Zinaida Elmazi	Vakat	
20	Seliman Osman	JGP	
21	Hatidza Šeh	JGP	
22	Laurat Krasniqi	LVetëvendosje	
23	Hajrudin Hodža	PGora	
24	Nexhat Isufi	Nisma	
25	Zaim Hajredini	AKR	
26	Florent Rufati	AAK	
27	Redžep Kamberi	GIG	

Dragash dt. 31. 01. 2019

Kryesuesi - Predsedavajuci